



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër:05-400/01-25062, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28, datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.6. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të komisionit të kuvendit dhe rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 55/2025

Për dhënien e titullit "Mirënjohje"

Dr. Mevlyde (Rashit) Popovci

1. **Dr. Mevlyde (Rashit) Popovci**, nga Komuna e Pejës, i jepet **"Mirënjohje"**, me motivacion:

"Për kontributin e sajë të jashtëzakonshëm shumëvjeçar në shërbim të qytetarëve dhe shëndetit publik, si mjeke. Si një mjeke e përkushtuar dhe profesioniste e shquar në shërbim të qytetarëve të Komunës së Pejës. Për aktivitetin e sajë politik në nivel lokal duke qenë anëtare e Kuvendit të Komunës dhe pastaj drejtoresh e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, si dhe tani kontribuese aktive si pjesë e këshillit për moshën e tretë".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të Qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj